

AKT NORMATIV
Nr.9, datë 11.12.2009

**PËR MËNYRËN E FUNKSIONIMIT E BURIMET E FINANCIMIT TË
SISTEMIT TË TACHOGRAPH DIGITAL NË SHQIPËRI**

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Neni 1

Autorizohen Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Transportit Rrugor, si ent jobuxhetor në varësi të kësaj ministrie, që, në zbatim të detyrimeve të parashikuara në ligjin nr.9514, datë 18.4.2006 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në marrëveshjen europiane “Për punën e ekuipazheve të mjeteve të përfshira në transportin ndërkombëtar rrugor (AETR) dhe në protokollin e nënshkrimit e në amendamentin nr.4 të saj”, të marrin masat e nevojshme për të bërë efektiv, brenda datës 16.6.2010, funksionimin e sistemit të takografit dixhital (tachograph digital), nëpërmjet bashkëpunimit në nivel institucional, për një periudhë 5-vjeçare, me institucionet homologe franceze, përfshirë furnizuesin zyrtar të qeverisë franceze, për shërbimin e takografit dixhital (tachograph digital) “Chronoservices/Imprimerie National” dhe Komisionin European.

Neni 2

Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit i propozon Komisionit European, që Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor të jetë autoriteti i lëshimit të kartave, në përputhje me procedurat e parashikuara në marrëveshjen (AETR).

Neni 3

Kartat e shoferëve, kartat e shoqërisë e kartat e oficinës së sistemit të takografit dixhital (tachograph digital) të lëshohen, kundrejt pagesës, nga autoriteti, i përcaktuar në nenin 2. Përjashtim bëjnë vetëm kartat e kontrollit të sistemit të takografit dixhital (tachograph digital), të cilat lëshohen pa pagesë nga i njëjti autoritet.

Neni 4

Kohëzgjatja e vlefshmërisë së kartave të aplikuara në Republikën e Shqipërisë në sistemin e takografit dixhital (tachograph digital) të jetë në kufirin e afateve maksimale, të lejuara nga direktivat europiane.

Neni 5

Të gjitha investimet për zbatimin e detyrimeve për funksionimin e sistemit të takografit dixhital (tachograph digital), sipas neneve 1, 2, 3 e 4 të këtij akti normativ, të bëhen me fonde jobuxhetore, të siguruara nga të ardhurat e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor.

Në çdo rast, norma e fitimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, gjatë zbatimit të këtij projekti, sipas nenit 2, për këtë shërbim, të mos tejkalojë 5% të

shpenzimeve, gjithsej.

Neni 6

Ministri përgjegjës për çështjet e transportit dhe Ministri i Financave miratojnë, brenda datës 10.5.2010, me udhëzim të përbashkët, tarifat përkatëse, në përputhje me nenin 3 të këtij akti normativ. Për mbrojtjen e interesave të klientëve (transportues, shoqëri transporti mallrash ndërkombëtare dhe ofiçinat), tarifa e aplikuar të jetë në euro.

Neni 7

Autoriteti i lëshimit të kartave të pajisë të gjitha autoritetet shtetërore të kontrollit me karta kontrolli, brenda 10 ditëve, por përpara datës 16 qershor 2010 dhe të marrë masa për organizimin e trajnimeve të përqendruara me këto autoritete, për njohjen dhe përdorimin efikas të sistemit (tachograph digital), si dhe të ndjekë të njëjtën procedurë, gjatë procesit të ripajisjes me karta kontrolli, për rastet kur ka mbaruar afati i vlefshmërisë së kartës, sipas marrëveshjes (AETR) apo për rastet e zëvendësimit të tyre, kur ato deklarohen të humbura ose të dëmtuara. Shprehja “Autoritet kontrolli”, sipas paragrafit të parë të këtij neni, u referohet autoriteteve shtetërore, të përcaktuara si autoritete kontrolli në ligjin nr.9514, datë 18.4.2006 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në marrëveshjen europiane “Për punën e ekuipazheve të mjeteve të përfshira në transportin ndërkombëtar rrugor (AETR) dhe në protokollin e nënshkrimit e në amendamentin nr.4 të saj””.

Neni 8

Kostot e lëshimit të kartave të kontrollit të autoriteteve të kontrollit, sipas paragrafit të parë dhe atij të dytë të nenit 5 të këtij akti normativ, t’i njihen autoritetit, të përcaktuar në nenin 2, si shpenzime të zbritshme, në masën 47,2 euro/copa, gjatë procesit të hartimit të pasqyrave financiare të të ardhurave e të shpenzimeve.

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha